



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
K A B I N E T I

Nr. 4280 prot.

Tiranë më 9/8/2004

URDHER


Per protokollimin dhe arshivimin e akteve te rendesishme ne fushen e marrdhenieve nderkombetare dhe te investimeve nga organizmat e huaj

Me qellim ruajtjen dhe perdorimin e dokumentacionit te rendesishem ne fushen e marrdhenieve nderkombetare, studimeve dhe investimeve te huaja ne sektoret e transportit dhe telekomunikacionit, Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit,

URDHERON

1. Te gjithë strukturat e sistemit te Ministrise se Transportit dhe Telekomunikacionit qe disponojne marrveshje, kontrata, studime, projekte apo akte te tjera te rendesishme qe rregullojne marrdhenie me shtete, organizma nderkombetare apo nenshkruar ne zbatim te projekteve me financim te huaj te bejne menjehere depozitim e te pakten nje kopje origjinale te dokumentit ne protokoll-arkivin e Ministrise.
2. Protokoll-arkivi i Ministrise te beje regjistrimin, protokollimin dhe indeksimin e dokumentacionit ne menyre manuale dhe elektronike si dhe te siguroje administrimin e tij ne perputhje me legjislacionin perkates.
3. Terheqja nga arshiva e Ministrise e dokumentacionit te percaktuar ne piken 1 te ketij urdheri, mund te behet vetem me autorizim nga Sekretari i Pergjithshem i Ministrise, me proces verbal te posacem dhe per nje periudhe jo me te gjate se dy dite kalendarike nga momenti i terheqjes.
4. Per moszbatim te kerkesave te ketij urdheri te merren masat perkatese disiplinore.
5. Me mbikqyrjen e zbatimit te ketij urdheri ngarkohet Sekretari i Pergjithshem dhe Drejtoria e Burimeve Njerezore ne Ministri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.


SPARTAK POÇI
MINISTËR

Nr. 1101/750
Dt. 01.08.2004

Zj. Pis
Për zbatim
31.08.04
CS



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE DHE SHERBIMEVE


Nr. 4280/prot.
1

Tiranë më 31.08.2004

Lenda: **Dergim urdheri per zbatim**

Drejtuar: Agjencisë së Përgj. të Mbrojtjes së Aërit etj

Bashkelidhur ju dergojme per zbatim Urdherin e Ministrit per protokollimin dhe arshivimin e akteve te rendesishme ne fushen e marredhenieve nderkombetare dhe te investimeve nga organizmat e huaj.


EDUARD PRODAN
Sekretar i Pergjithshem

